

REPUBLICA E SHQIPERISE  
PROKURORIA

1

PRANE  
GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

DOSJA - PENALE

PROÇEDIMI PENAL NR 1318  
KALLZIMI NR \_\_\_\_\_

| TE PANDEHUR   | AKUZA                  | NENI   |
|---------------|------------------------|--------|
| A. Minhozi    | Shkelqje te barazise   | 258-25 |
| D. Cemi       | pjesemarrjeve ne       |        |
| S. Bilbulushi | teudara ne bashklojune |        |
| S. Taroni     |                        |        |
| A. Tani       |                        |        |

A. Kujossi  
Q. Ribaj k. Bilaj  
Pol. Gjyqsore qe heton çështjen  
Enkelt Gjini

| PROKURORET             |
|------------------------|
| 1. <u>Beshnik Cani</u> |
| 2.                     |
| 3.                     |
| 4.                     |
| 5.                     |

*Arrest*

|                      |            |         |           |
|----------------------|------------|---------|-----------|
| ATA E RREGJISTRIMIT: | 7.05.2004. |         |           |
| ATA E PERFUNDIMIT:   | 2.12.04.   |         |           |
| GJYQIT               | PEZULLUAR  | PUSHUAR | MOSFILLIM |

ARSHIVUAR

DATA: 30.11.05 TITULLAR \_\_\_\_\_

*Arrest*

Nr. i arshivës \_\_\_\_\_



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQSOR TIRANË

**V E N D I M**

***“Mbi delegimin e kompetencave”***

***Në Tiranë, sot më datë 15 Maj 2004,***

*Unë, Besnik CANI, me detyrë Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi studjova aktet e procedimit penal Nr.1318-1329, të vitit 2004,*

**K O N S T A T O V A :**

*Mbi baze të kallezimit të K.LSH, me date 07.05.2004 Prokuroria ka rregjistruar procedimet penale nr 1318-1329, për veprën penale të “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën kryer në bashkëpunim” në ngarkim të shtetasve Agim Minxhozi etj.*

*Për sa sipër, në mbështetje të nenit 304/2 të K.Pr.Penale,*

**V E N D O S A**

- 1.Delegimin e kompetencave për hetimin e kësaj çështjeje, sipas planit të hetimit të dates 15.05.2004, Of.Pol.Gjyqsore, Enklid Gjini.*
- 2.Veprimet hetimore të deleguara të kryhen deri me date 30.06.2004.*
- 3.Te raportohet për veprimet e kryera në vazhdimësi me qëllim, lenjen e detyrave të tjera.*

**PROKURORI**  
  
**Besnik CANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**PLAN HETIMI**

*“ Për çështjen penale Nr 1318 -1329. te vitit 2004 “*

*Mbi baze te kallezimit te KLSH, me date 07.05.2004 Prokuroria ka rregjistruar procedimin penal nr 1318, 1319, 1320, 1321, 1322, 1324, 1325, 1326, 1327, 1328 dhe 1329, per vepren penale te “vjedhjes duke shperdoruar detyren kryer ne bashkepunim” ne ngarkim te shtetasve Agim Minxhozi etj*

**Rrethanat e çështjes**

*Prane MASH, ne vitin 2002 dhe 2003 jane zhvilluar disa tendera te perqendruar, te cilat jane kontrolluar nga KLSH. Nga KLSH jane konstatuar se nga ana e anetareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, dhe te njesise se prokurimit, jane bere veprime ne kundërshtim me ligjin, duke pranuar oferta te korigjuara dhe duke pakesuar me dashje buxhetin e shtetit. Konkretisht ne zhvillimin e procedurave te tenderave:*

- 1. Ndertim shkolla Petove Fier.*
- 2. Ndertim i shkolles tetevjeçare Marklekaj Lezhe.*
- 3. Ndertim i shkolles 10 Korriku Tirane.*
- 4. Rikonstruksion shëtesa e shkolles Babrru Tirane*
- 5. Rikonstruksion shkolla Hoçisht Devoll.*
- 6. Qendra Kulturore e femijeve Vlore.*
- 7. Shkolla e Re e gjuheve te huaja Korçe.*
- 8. Godine e re per Universitetin Fan Noli Korçe.*
- 9. Rikonstruksion i konviktit te shkolles se muzikes Elbasan*
- 10. Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme tregtare Vlore.*
- 11. Rikonstruksion i shkolles se mesme K Isak Berat.*
- 12. Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme ekonomike Tirane.*

*Për të qenë më të qartë se çfarë kërkohet të sqarohet gjatë hetimit të kësaj çështjeje, duhet të referohemi në ligjin ne 7971 date 26.07.1995 “ Per Prokurimin Publik”, si dhe te gjitha aktet nen/ligjore te dala per zbatim te tij.*

***Në funksion të këtij hetimi, për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, del e nevojshme të sqarohen hollësisht këto elementë :***

• Menyra dhe arsyeja e vertet e pranimit nga KVO te ofertave me korigjime. A jane keto korigjime ne perputhje me kerkesat e ligjit per nje ofert te vlefshme.

• Nga kush jane bere keto korigjime, pra nga ofertuesit apo ndonje prej anetareve te KVO. A kane sjelle ndikim ne vleren e ofertes fituese keto korigjime, nese po sa eshte ky ndikim.

• Paksimi i buxhetit te shtetit, ka ardhur nga veprimet a mosveprimet e anetareve te KVO, apo jemi para veprimeve te bera me dashje ne bashkepunim me ofertuesin fitues per te realizuar vjedhje te buxhetit te shtetit.

• Korigjimet, a jane vetem, ne ofertat fituese apo jane te shtrira edhe ne ofertat e konkureteve te tjere.

• Ndryshimet ndermjet vleres se ofertes ne formular, dhe asaj ne preventiv, a kane ardhur vetem nga korigjimet apo edhe nga veprime aritmetike te gabueshme.

• A jane njohur ofertuesit me vlerat e korigjuara dhe a ka patur ankim nga ana e tyre.

### **VEPRIMET QË DALIN TË NEVOJSHME TË KRYHEN :**

Në funksion të këtyre hipotezave, që mbështesin në fakt versionet hetimore, se keto veprime jane bere ne bashkepunim me ofertesit fitues me qellim vjedhjen e buxhetit 26.07.1995 " Per Prokurimin Publik"

Te sekuestrohen ne origjinal:

1. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion shkolla Hoçisht Devoll", me urdher prokurimi nr 33, date 07.08.2003, me fond limit 15 000 000 leke si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
2. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion shtesa e shkolles Babru Tirane", me urdher prokurimi nr 33, date 07.08.2003, me fond limit 28 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
3. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Ndertim shkolla Petove Fier", me urdher prokurimi nr

24, date 19.05.20003, me fond limit 20 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, akime te ofertuesve

4. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Ndertim shkolla 10 Korriku", me urdher prokurimi nr 33, date 07.08.2003, me fond limit 70 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, akime te ofertuesve.
5. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Ndertim shkolla e re e Gjuheve te Huaja Korçe", me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 55 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, akime te ofertuesve.
6. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Godine e Re per Universitetin Fan Noli Korçe", me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 50 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
7. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme tregtare Vlore", me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 43 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
8. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme te

| TRUPI GJYKUES |            |
|---------------|------------|
| 1             | EMIR PETRU |
| 2             |            |
| 3             |            |

| Nr. | Seanca gjyqsore<br>(data e seancës) | Arsyeja e shtyrjes                       | Përfundimi |
|-----|-------------------------------------|--|------------|
| 1   | 11.03.01                            | Muh u parqyt anshkëti                    |            |
| 2   | 18.03.01                            |  |            |
| 3   | 04.04.01                            | u parqytë 01' ne vorell                  |            |
| 4   | 20.04.01                            |  |            |
| 5   | 11.05.01                            |  |            |
| 6   | 19.05.01                            |  |            |
| 7   | 06.06.01                            | Kardorezuar dorzja per i shpallë spital, |            |
| 8   | 13.06.01                            | Konkurrenca                              |            |
| 9   | 14.09.01                            | Muh u parqyt konkurrenca                 |            |
|     | 28.09.01                            |  |            |
|     | 10.10.01                            |  |            |
|     | 21.10.01                            |  |            |
|     | 14.11.01                            |  |            |

| Vendimi i Gjykatës Nr. _____ Di 14.11.01     |                             |
|--|-----------------------------|
| Deblaraj fajtos te pandalunet dhe ca 6.258/1 |                             |
| i detyroi (me:                               |                             |
| A. Minderaj = 700.000 l. qj;                 | A. Kujeraj = 250.000        |
| D. Cenaj = 250.000                           | B. Ruzic = 400.000 l. qj    |
| A. Tomaj = 400.000 l. qj;                    | 3. Bibumbaj = 100.000 l. qj |
| A. G. G. = 250.000 l. qj                     |                             |

| PROKURORI I RRETHIT |  |
|---------------------|--|
|                     |  |
|                     |  |
|                     |  |
|                     |  |
|                     |  |

muzikes Elbasan", me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 32 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.. 72

9. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme K. Isak Berat", me urdher prokurimi nr 16, date 22.08.2002, me fond limit 17 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
10. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Ndertim i shkolles tetevjeçare Marklekaj Lezhe, me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 32 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve.
11. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesma ekonomike Tirane, me urdher prokurimi nr 17, date 27.08.2002, me fond limit 40 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues, ankime te ofertuesve
12. Dokumentacioni i plote ne origjinal i tenderit me objekt " Qendra Kulturore e femijeve Vlore, me urdher prokurimi nr 6, date 06.03.2003, me fond limit 15 000 000 leke, si, urdher prokurimi, procesverbalet e K.V.O, njoftimet, vendimet e K.V.O dhe te Kryetarit te Entit Prokurues, ofertat e konkurenteve qe nuk jane shpallur fitues, dokumentet e shitura nga enti Prokurues

a) Te thirret dhe te pyetet ne cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime shtetasit Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Valbona Sanxhaktari, Kujtim Bilaj, Shpresa Noka, Arta Tari, Merita Tershana, Qerim Ribaj, Sokol Bilbilushi, Arben Kujoca, ku ti kerkohen shpjegime per çdo episod te kallezuar nga KLSH, ne lidhje

me procedurat e ndjekura ne tenderim, si jane hapur dhe pranuar ofertat, a jane konstatuar korigjimet, kush ka bere kontrollimin e veprimeve aritmetike te ofertave, a kane qene ofertat ne perputhje me kerkesat e shpallura ne tender, a jane njoftuar ofertuesit ne lidhje me vlerat e korigjuara, a jane kontrolluar ndonjehere nga APP, nese po ne cilin tender konkretisht dhe cili eshte mendimi i tyre, a eshte shtrire kjo forme e te pranuarit te ofertave te korigjuara ne vite te tjera, dhe a u jane nenshtruar kontrollit te KLSH, a kane patur ankime nga ofertuesit nese po per cilet tendera konkretisht.

b) Te thirret dhe te pyetet ne cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime shtetasit Osman Dollani, Arben Avduli, Tatiana Bregu, Moisi Islami, Spartak Meraku, Lefter Alla, Pilo Keri, Gjon Lesaj, Ymer Murati, ku te japi shpjegime ne lidhje me ofertat e tyre te ofruara per cdo episod te kallezuar, kush i ka bere korigjimet e ofertave nese kane, cili ka qene qellimi i berjes se ketyre korigjimeve, ku i kane bere keto korigjime (ne sallen e zhvillimit te tenderit apo jashte saj). Si i kane dorezuar zarfat me ofertat ne KVO, a jane vene ne dijeni per vlerat e korigjuara, a kane bere ankim ne lidhje me to, cfare marredhenjesh kane me anetaret e K.V.O dhe Njesise se Prokurimit, si jane zhvilluar procedurat e tenderimit. Korigjimet a jane ne perputhje me ligjin per prokurimin publik, dhe kerkesat e entit prokurues etj.

c) Te thiren dhe te pyeten ne cilesine e personit qe kane dijeni per rrethana te dobishme te hetimeve, te gjitha perfaqesuesit e ofertuesve qe kane marre pjese ne tendera dhe jane klasifikuar por nuk jane shpallur fitues, nese kane bere korigjime ne ofertat e tyre, t'iu tregohen ato dhe te pyeten per kete fakt. A jane njoftuar per korigjim te vlerave te ofertave te ofruara nga Enti Prokurues, nese po me cfare mjeti jane njoftuar, a kane bere ankime ne sepo si u eshte dhene zgjidhje etj.

d) Te administrohen prane INSTAT, indekset e cmimeve te lendeve e punimeve te ndertimit per vitin 2002 e 2003, dhe te verifikohet nese personat pergjegjes ne MASH u jane permbajtuar atyre ne lidhje me perilogaritjen e fondit limit, si dhe te identifikohet ato persona qe kane bere planifikimin e fondeve per cdo tender.

e) Te kryhet ekspertim grafik per ofertat e korigjuara, me qellim percaktimin numrave te korigjuar, qe te sherbeje per ekspertimin kontabel per te pare vleren e ndryshimit te ardhur, si dhe per te percaktuar nese korigjimet dhe nenshkrimet prane korigjimeve jane te ofertuesve apo jo.

f) Te kryhet ekspertim kontabel, per te percaktuar nese me te vertet ka ardhur dem i buxhetit te shtetit si rezultat e ketyre korigjimeve etj.

g) Te thirren dhe te pyeten specialsitet e KLSH qe kane ushtruar kontrollin per te bere sqarime ne lidhje me shkeljet qe ato kane prezantuar

h) Te hetohet ne lidhje me pasurite e anetareve te K.V.O dhe Njesise se Prokurimit, duke administruar prane Inspektoriatit te Kontrollit te Pasurive, deklaratat e tyre te pasurive, si dhe verifikimin fizik te tyre, si ne ZRPP, Banka etj.



i) Të kryhen veprime të tjera hetimore që dalin gjate dinamikës së hetimit. 79

**Në dinamikë, ky plan do të pasurohet edhe me veprime të tjera.**

Tiranë më 15.05. 2004.

**PROKURORI**  
  
**Besnik CANI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

**V E N D I M**

*"Për regjistrimin e procedimit penal"*

*Në Tiranë, viti 2004, muaji Maj, data 07*

Unë **Vexhi MUÇMATA**, me detyrë Prokuror i Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi studiova materialin kallëzues nr 1767 te vitit 2004,

**K O N S T A T O V A**

Me date 07.05.2004 ne Prokurorine e rrethit Gjyqesor Tirane, nga Kontrolli i Larte i Shtetit Tirane, ka ardhur kallezimi penal nr 1767, ne te cilin kallezohen per ndjekje penale shtetasit Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi, dhe Arben Abduli se ne prokurimin e fondeve publike te MASH, per vitin 2003, ne bashkepunim ka kryer vepren penale te vjedhjes duke shperdoruar detyren.

*Për këto arsye, bazuar ne nenin 287 te K.Pr. Penale,*

**V E N D O S A**

Të regjistroj procedimin penal, për veprën penale te "vjedhjes duke shperdoruar detyren" kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 135-25 te K.P ne ngarkim te Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Kujtim Bilaj, **Valbona Sanxhaktari**, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi, dhe Arben Avduli

Për hetimin e këtij procedimi ngarkohet prokurori **Besnik CANI**

**PROKURORI I RRETHIT**

**Vexhi MUÇMATA**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086/Prot.

Tirane, me 5.05 2004



Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare

TIRANE

**LE N D A : KALLEZIM PENAL:**

*Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Arben Avduli, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te veprës penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".*

*Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushruar kontroll ekonomik-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disaprej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme te muzikes, Elbasan"**, me **limit 32.000.000 leke**, me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdheri te prokurimit nr.6 date 06.03.2003. Sipas ketij urdheri eshte ngritur Komisioni i

Vleresimit te Ofertave i perbere nga: Agim Minxhozi kryetar, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj anetare dhe Hartuesit e Dokumentave te Tenderit, perbere nga: Valbona Sanxhaktari juriste, Merita Tershana dhe Sokol Bilbilushi anetare, qe te gjithe punonjes te sistemit te Ministrise Arsimit e Shkences dhe me banim ne Tirane sipas rregjistrimit te personelit te kesaj ministrie.

Nga kontrolli i dokumentacionit te dosjes se ketij tenderi rezultuan shkelje te dispozitave ligjore per prokurimin publik dhe shkelje te tjera ne ushtrimin e detyres me pasoje dem ekonomik per buxhetin e shtetit ne shumen 7.253.559 leke. Pasi u moren gjate procesit kontrollues, observacionet perkatese nga personat e pergjegjesuar dhe pas shqyrtimit te shkeljeve, e te ballafaqimeve te shumta e te pasqyruara edhe ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit, u konkludua nga ana jone se nga: Agim Minxhozi me detyre Sekretar i Pergjithshem i Ministrise se Arsimit dhe Shkences(MASH), me profesion fizikant, Sokol Turani me detyre ish-Drejtor i Burimeve Njerezore prane MASH, me profesion ekonomist, Dafina Cenaj me detyre Specialiste e Drejtorise se Buxhetit prane MASH, me profesion ekonomiste, Qerim Ribaj me detyre Specialist i Drejtorise Arsimore Qyteti Tirane, me profesion inxhinier ndertimi, Kujtim Bilaj me detyre Pergjegjes i Sektorit te Investimeve prane Drejtorise Arsimore Qyteti Tirane, me profesion inxhinier ndertimi, Valbona Sanxhaktari me detyre Specialiste e Drejtorise Juridike prane MASH, me profesion juriste, Merita Tershana me detyre Specialiste e Njesise se Prokurimit prane MASH, me profesion ekonomiste, Sokol Bilbilushi me detyre Specialist i Drejtorise se Investimeve prane MASH, me profesion inxhinier ndertimi dhe Arben Avduli ne cilesine e perfaqesuesit te shoqerise "Avduli" Vlore, kane kryer veprime te kundraligjshme duke vjedhur buxhetin e shtetit ne shumen 7.253.559 leke, veprime te cilat konsistojne si me poshte vijon:

Ne Dokumentat e Tenderit, te pergatitura nga Hartuesit e Dokumentave te Tenderit dhe Komisioni i Vleresimit te Ofertave, ne piken 21 "Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave", parashikohet: ".....Cmimi per njesi do te jete i qarte, pa korrigjim."

Ne fakt, ne procesin e pranimit dhe shqyrtimit te ofertave nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, kjo kerkese e Dokumentave te Tenderit te miratuara nga vete Komisioni dhe te shperndara konkurrenteve, nuk eshte respektuar, dhe gjithashtu ishte shkelur Ligji nr.7971 date 26.07.1995 "Per Prokurimin Publik", neni 32 "Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave", pasi eshte proceduar si me poshte"

Eshte pranuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, i korigjuar preventiv i shoqerise fituese "Avduli", i nenshkruar nga perfaqesuesi i shoqerise Arben Avduli (originali i preventivit i bashkengjitet kallezimit) . Madje per keto korigjime nuk eshte lene gjurme ne asnje proces verbal te ketij komisioni gjate momenteve te zhvillimit te tenderit sic percakton ligji i prokurimeve qe cdo veprim te shoqerohet me proces verbale sqaruese.Duke u ndodhur para ketyre fakteve institucioni yne nuk eshte ne gjendje se kush i ka bere keto korigjime, komisioni i vlersimit te oferave apo kokurentet konkurues.

Konkretisht korigjimet jane bere ne zerat si me poshte:

Sipas proces verbalit te hapjes se tenderit te dates 22.04.2003 kane blere dokumentat e tenderit 20 konkurente, jane paraqitur 4 jane s'kualifikuar 2, per mangesi ne dokumentacionin ligjor. Kane vazhduar garen konkurentet "Avduli" me vlere 22.502.858 leke dhe "Agfa" me vlere 29.800.000 leke.

Nga kontrolli i ofertave tekniko ekonomike rezulton:

Oferta ekonomike e fituesit "Avduli" eshte ofruar ne vleren 22.502.858 leke, cka provohet edhe nga formulari i ofertes i paraqitur i nenshkruar nga oferuesi (origjinali i bashkelidhet kallezimit), dhe sipas proces verbalit te mbajtur nga komisioni i vleresimit te ofertave ne daten 22.04.2003 per klasifikimin e konkurrenteve pjesemarrës ne tender, rezulton se eshte rritur vlera e ofertes se fituesit ne 7.253.559 leke me teper, si rezultat i korigjimit te gabimeve aritmetike e konkretisht:

| Konkurenti | Vlera e ofruar  | Vlera e korigjuar |
|------------|-----------------|-------------------|
| Avduli     | 22.502.858 leke | 29.756.417 leke.  |
| Agfa       | 29.800.000 leke | 29.799.575 leke.  |

Ne fakt ne preventivin e konkurentit fitues jane te korigjuara dukshem, ne ulje çmimet e ofruara si me poshte:

Ne fleten e pare te preventivit, ne zerat:

-Lyerje me boje plastike me vlere 108.000 leke ( $600 \text{ m}^2 \times 180 \text{ leke}$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi jane korigjuar çmimi dhe vlera dhe nuk jane lene gjurme te tjera te dukshme.

-Suvatim mur i brendshem me vlere 821.600 leke ( $2.560 \text{ m}^2 \times 300 \text{ leke}$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 768.000 leke ( $2560 \text{ m}^2 \times 300 \text{ leke}$ ), ose me pak 53.600 leke, duke kryer veprimin aritmetik rezulton se çmimi ka qene 321 leke  $\text{m}^2$  ( $821.600 : 2.560$ ), pasi eshte lene gjurme ne shikimin e te dy vleftave, por jo te çmimeve.

-Dritare duralumini me vlere 315.000 leke ( $45 \text{ m}^2 \times 7.000 \text{ leke}$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 90.000 leke ( $45 \text{ m}^2 \times 2.000 \text{ leke}$ ), ose me pak 225.000 leke, ne kete rast eshte korigjuar çmimi dhe vlera, pasi eshte lene gjurme ne leximin e tyre.

-Dyer druri me vlere 136.000 leke ( $16 \text{ m}^2 \times 8.500 \text{ leke}$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 128.000 leke ( $16 \text{ m}^2 \times 8.000 \text{ leke}$ ), ose me pak 8.000 leke, ne kete rast eshte korigjuar çmimi dhe vlera, duke lene gjurme ne leximin e tyre.

-Lyerje me boje plastike me vlere 268.000 leke ( $1.340 \text{ m}^2 \times 200 \text{ leke}$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar çmimi dhe vlera, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Ne fleten e dyte te preventivit, ne zerin:

-Furnizim vendosje dritare duralumini me vlere 28.000 leke ( $4 \text{ copex} 7.000 \text{ leke}$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 8.000 leke ( $4 \text{ copex} 2.000 \text{ leke}$ ), ose me pak 20.000 leke, ne kete rast eshte korigjuar çmimi, duke lene gjurme ne leximin e tyre. Ne te njejten flete te preventivit, zerat "furnizim vendosje dritare duralumini" dhe "furnizim vendosje dyer druri kase binari", jane

37

ofruar perkatesisht me cmimet 7.000 leke dhe 8.500 leke, cmime te cilat ne vende te tjera te preventivit jane ndryshuar perkatesisht ne 2.000 leke dhe 8.000 leke.

Ne fleten e trete te preventivit, ne zerat:

-Dritare duralumini me vlere 1.890.000 leke( $270m^2 \times 7.000leke$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 540.000 leke( $270m^2 \times 2.000leke$ ), ose me pak 1.350.000 leke, ne kete rast eshte korigjuar cmimi, duke lene gjurme ne leximin e tyre.

-Dyer druri kase binari me vlere 1.292.000 leke( $152m^2 \times 8.500leke$ ), eshte llogaritur pas korigjimit te gabimeve aritmetike me vlere 1.216.000 leke( $152m^2 \times 8.000leke$ ), ose me pak 76.000 leke, ne kete rast eshte korigjuar cmimi, duke lene gjurme ne leximin e tyre.

Ne fleten e gjashte te preventivit, ne zerin "Vendosje Aeroterme 6000 ë", me vlere 100.000 leke( $Scopex20.000leke$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar cmimi dhe vlera, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Duhet theksuar se per zerin e mesiperm "Vendosje Aeroterme 6000ë", cmimi i korigjuar ne 20.000 leke eshte jo vetem i parregullit, por veprimi i korigjimit te cmimit eshte haptazi abuzues dhe me qellim perfitimi, si nga autori i korigjimit edhe nga personat qe e kane pranuar te tille, pasi nga kontrolli i tenderave te tjere te zhvilluar nga po ky institucion, rezultoi se per te njejtin ze pune, ne tendera te tjere eshte ofruar si me poshte:

-Ne tenderin "Rikonstruksion i konviktit te shkolles K.Isak, Berat", ofertuesi fitues "Besa", per kete ze, duke perfshire edhe furnizimin ka ofruar cmimin 1.400 leke(*fotokopja e preventivit i bashkengjitet kallezimit*).

-Ne tenderin "Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme tregtare, Vlore", i njejti ofertues fitues "Avduli", per kete ze ka ofruar cmimin 3.500 leke(*fotokopja e preventivit i bashkengjitet kallezimit*).

Duket qarte se per kete ze pune cmimi i ndryshuar ne 20.000 leke eshte teresisht jashte cmimeve te tregut, dhe si korigjimi i tij, edhe pranimi nga ana e anetareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, e sidomos nga ana e inxhinierëve te ndertimit, eshte bere me qellim vjedhjen e fondeve publike.

Ne fleten e tete te preventivit, ne zerat:

- "Vendosje Kaldaje uji gize me fuqi 280 kë", me vlere 20.000 leke( $1copex20.000leke$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar cmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

- "FV Manometer", me vlere 3.000 leke( $2copex1.500leke$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar cmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

- "FV Ventil reduksioni" me mbushes automatik, me vlere 2.000 leke ( $1copex2.000leke$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar cmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

- "FV Fluksostat 2" i rregullueshem", me vlere 2.000 leke( $1copex2.000leke$ ), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korigjuar cmimi dhe vlera, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

- "FV Ene zgjerimi 500 liter", me vlere 8.000 leke (1 copex 8.000 leke), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korrigjuar çmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Per te gjitha cmimet e korrigjuara, te konstatuara edhe ne kete flete te preventivit, ka vend per krahasime me cmimet e te njejtave zera pune, te ofruara nga po kjo shoqeri, ne tenderin "Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme tregtare, Vlore" (Kopja e preventivit i bashkengjitet kallezimit)

Ne fleten e nente te preventivit, ne zerat:

- "FV Tuba plastik d50", me vlere 9.000 leke (45 ml x 200 leke), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte e korrigjuar çmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

- "FV Kontator me mbrojtje termike", me vlere 120.000 leke (6 copex 20.000 leke), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korrigjuar çmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Ne fleten e dhjete te preventivit, ne zerat:

- "F Manometer 0-6 bar", me vlere 60.000 leke (2 copex 30.000 leke), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte e korrigjuar çmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Edhe ne kete rast ka vend per krahasime me cmimin e te njejtave zera pune, te ofruar nga po kjo shoqeri, ne tenderin "Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme tregtare, Vlore" (Kopja e preventivit i bashkengjitet kallezimit)

- "F Paisje gjysem e shpejte per kembim nxehtesie", me vlere 200.000 leke (2 copex 20.000 leke), ne kete rast nuk mund te behet krahasim, pasi eshte korrigjuar çmimi, duke mos lene gjurme te tjera te dukshme.

Nga verifikimi i preventivit te konkurentit fitues "Avduli" dhe pas mbledhjes se zerave te preventivit deri ne totalin e punimeve te rikonstruksionit (Shuma A) vlera eshte 18.974.661 leke, nderkohe qe duke shtuar totalin e sistemit te ngrohjes (Shuma B+C+D+E), shuma totale ka dale 11.152.045 leke, me te drejte lind pyetja si del shuma e preventivit me e vogel se shuma e mesiperme, nderkohe qe jane shtuar komplet punimet e sistemit te ngrohjes? Shuma e preventivit ka qene 21.152.045 leke dhe pas shumezimit me strukturat e kosos se ndertimit shuma del 30.228.218 leke, te ciles po ti shtohet edhe shuma e paisjeve te shumezuar me TVSH, vlera totale e ofertes del 31.502.858 leke. Pra vlera reale e perlllogaritur per tu ofruar fillimisht nga konkurenti "Avduli" ka qene 31.502.858 leke, e cila eshte korrigjuar me korrektor ne 22.502.858 leke.

- Komisioni i vleresimit te ofertave nuk duhej te pranonte oferten me korrigjime si ne zera te veçante ashtu edhe ne shumen totale, pasi kjo gje eshte ne kundërshtim me vete dokumentat e tenderit te miratuara ku thuhet shprehimisht se çmimet duhet te jene te qarta dhe pa korrigjime si edhe me Dokumentat Standarte te Tenderit pika 25 "Shpjegimi dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike".

Per rritjen e vleres nga Enti prokurues, nuk ka konfirmim me shkrim nga ofertuesi per te pranuar vleften e korrigjuar, bazuar ne dokumentat e tenderit, te miratuara nga komisioni i vleresimit te ofertave, "Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave"

34

ku thuhet: Ministria e Arsimit dhe Shkences me pranimin e ofertuesit, do te korrigoje shumen totale te ofertes.

E pare ne kete prizem, rezulton se ofertuesi "Avduli", i perfaqesuar nga Arben Avduli, ka paraqitur nje oferte, preventivi i se ciles, pervec korigjimeve te shumave totale dhe pasaktesive ne mbledhjen e tyre, mbart hap pas hapi cmime te korigjuara, vlerat e te cilave me pas jane bere pjese totalit te korigjimit te gabimeve aritmetike nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave. Edhe fakti qe Komisioni i Vleresimit te Ofertave, nuk i ka shoqeruar keto korigjime aritmetike me nje liste analitike te zerave me gabime, tregon se shuma totale prej 7.253.559 leke me te cilen eshte rritur oferta pas korigjimit te gabimeve aritmetike, perfaqeson nje rritje te pajustificuar te ofertes, rritje e cila ka ardhur si pasoje e nderhyrjeve te parregullta ne oferten e paraqitur dhe te pranimit te tyre nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave.

Pershkrimi i veprimeve te mesiperme, te cilat kane sjelle si pasoje zvogelimin e buxhetit te shtetit ne shumen **7.253.559 leke** (29.756.417 leke - 22.502.858 leke), tregon se shkaktaret e drejtperdrejte te kesaj humbjeje dhe perfitues te kesaj vlere kane qene anetaret e Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe Hartuesit e Dokumentave te Tenderit, ne cilesine e personave pergjegjes per organizimin e te gjitha procedures se prokurimit, pra dhe te shqyrtimit e vleresimit te ofertave dhe te vetmit te autorizuar per perpunimin e preventivave te paraqitur ne tender, por edhe perfaqesuesi i shoqerise "Avduli", si autor i preventivit te paraqitur ne tender me te cilin edhe eshte shpallur fitues.

Mbeshtetur ne sa me siper mendojme se Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, **Valbona Sanxhaktari**, Merita Tershana dhe Sokol Bilbilushi, gjate permbushjes se detyres per zhvillimin e procedurave te prokurimit per "Rikonstrukcion i konviktit te shkolles se mesme te muzikes, Elbasan", kane kryer veprimet e kundraligjshme te pershkruara me siper, ne bashkepunim, me ndihmen e perfaqesuesit te shoqerise "Avduli", Arben Avduli dhe si pasoje kane perfituar ne dem te buxhetit te shtetit, shumen prej **7.253.559 leke**.

Duke i konsideruar veprimet e kryera me pasoja te renda per interesat e shtetit dhe te denueshme sipas Ligjit nr.7895 date 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikes se Shqiperise", ndryshuar me Ligjin nr.8733 date 24.01.2001, nenet 25, 26 dhe 135, ju dergojme kete kallezim penal, per veprime te metejshme procedurale.

Bashkelidhur ju dergojme dokumentat mbeshtetes sipas Listes nr.1.





102

PROKURORIA E RRETHIT TIRANE  
Nr. Prot. 3/38  
Data 7.5.04



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Rruga "Qemal Stafa" .....Tirane....Tel/Fax....04229085

Tiranë, më 07.05.2004

Nr. 1356/

PROC. PENAL Nr. 1318/1329  
DATA 01.05.2004  
1463-1444  
07.05.2004

**PROKURORISË SË RRETHIT**

**TIRANË**

Bashkëlidhur ju dërgojmë për kompetencë, 12 kallxime të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ardhur tek ne me shkresën nr. 1086, datë 05.05.2004, të cilat bëjnë fjalë për veprën penale të vjedhjes nëpërmjet shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, të kryer nga punonjës të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Merrni masa për hetimin e këtyre kallzimeve në një kohë sa më të shpejtë dhe me cilësi, duke bashkëpunuar në vijimësi edhe me specialistët e Kontrollit të Lartë të Shtetit që kanë ushtruar kontroll për problemet që kallzohen.

Brenda muajit Qershor 2004 duhet të dërgoni informacion me shkrim për ecurinë e këtyre procedimeve pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**  
**THEODHORI SOLLAKU**



103



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086 / Prot.

Tirane, me 5.05 2004

24

PROC. PENALE N. 1318  
DATA 07.05 VITI 2004

Prokurorise prane Gjykares se Shkalles se Pare

1460

TIRANE

DATA 07.05 VITI 2004

**LEND A : KALLEZIM PENAL:**

*Ndaj: Agim Minxhozi, Arben Kujosa, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Armand Baçe, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Spartak Meraku, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".*

*Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomiko-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtrojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Rikonstruksion shkolla Hociisht, Devoll", me fond limit 15.000.000 leke**, me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.33 date



REPubLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

**PROCESVERBAL**

Per deklarimin e shtetasit ndaj të cilit zhvillohen hetime

Ne Tirane sot me date, 07.06.2004, une Enklid GJINI me detyrë Of.Pol.Gjyqësore prane kesaj prokurorie, ne mbeshtetje te nenit 303/2 gërma b, te K.pr.Penale, mbaj kete procesverbal mbi marrjen ne pyetje te shtetases Valbona Sanxhaktari, e bija e Edmond dhe e Elvira, i vitlindjes 1974, lindur ne Tirane, banues ne Tiranë, Rr"Ferit Xhajko" pall nr 57/1, ap 5, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, me gjendje gjyqesore e pa denuar, me arsim te larte, me profesion juriste, pasi ndaj saj po zhvillohen hetime për veprën penale të Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën ne bashkepunim parashikuar nga neni 135 e 25 te K.Penal.

**DEKLARATE**

**Pyetje:** Ju vëmë në dijeni se ndaj jush po zhvillohen hetime për veprën penale të Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën kryer ne bashkepunim parashikuar nga neni 135-25 i K.penal. Në bazë të ligjit ju njohim me të drejtën për tu mbrojtur me avokat dhe për të mos dhënë shpjegime. Pra a doni avokat dhe a do të jepni shpjegime?

**Përgjigje:** Do të jap shpjegime pa avokat dhe ne lidhje me çka me atribuohen shpjegoj si me poshte;

Jam me arsim te larte juridik, dhe kam qene e punesuar ne Ministrine e Arsimit qe prej dates 1 Nentor 2001, me detyren e juristes ne sektorin juridik. Ne vitin 2003 eshte bere riorganizimi i Ministrise dhe eshte krijuar Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, e ndare ne dy sector , sektori i prokurimeve dhe sektori juridik. Une kam mbetur specialste-juriste prane kesaj Drejtorie. Une kam marre pjese si juriste ne disa tendera te vitit 2002 dhe 2003. Pas i ne disa te tjera ka qene shtetasi Armand Baçe, dhe Genti Çule.

Sot keta dy shtetas nuk punojne me ne MASH. E shoh te arsyeshme qe te shpjegoj detyren e jurists se njesise se prokurimit. Detyra e juristit ne njesine e prokurimit rregullohet me Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr 1 date 1.01.1996 " Per Rregullat e Prokurimit Publik", kapitulli IV. Ne kete kapitull eshte percaktuar se detyra e njesise se prokurimit dhe e juristit ne veçanti. Sipas këtij Udhezimi njesia e prokurimit, ne zhvillimin e nje tenderi eshte pergjegjese per : shpalljen e njoftimeve, shperndarjen e ofertave, dergimin per botim ne APP dhe ne gazeta te ofertave, sigurimin e materialeve per plotesimin e dokumentacionit te tenderit, sigurimin e formularve standart , sqarimin e kandidateve, etj. Ne kete udhezim, eshte percaktuar se : juristi ka pergjegjesine e zbatimit te procedurave mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi dhe te drejten e pezullimit te ketyre procedurave, kur ve re shkeljen e tyre. Njësia e prokurimit nuk ka qënë e plotësuar në strukturën e saj për këtë arsye caktohej juristi për cdo urdhër prokurimi në njësinë e hartimit të dokumentave të tenderit.

Në tenderat e vitit 2002 ku unë kam qënë e caktuar në njësinë e hartimit të dokumentave në pozicionin e juristit, fillimisht përgatiteshin dokumentat e tenderit, ku në gjithë pjesën e dokumentacionit standart përdorej materiali standart i ardhur nga APP, specifikimet teknike dhe preventivat përgatiteshin nga inxhinierët anëtarë të njësisë. Dokumentacionit i viheshin në dispozicion KVO dhe pasi miratoheshin e firmoseshin dilnin në shitje. Në datën e caktuar për tender mmbilidhej KVO dhe Njësia e Prokurimit. Fillonte procedura për firmat pjesëmarrëse me mbledhjen e zarfave dhe me verifikimin e dokumentacionit ligjor kualifikues. Dorëzoheshin katër zarfa dy origjinalë e dy kopje. Fillimish porocedohej me hapjen e zarfit që kishte dokumentacionin ligjor kualifikues. Zarfi hapej nga Kryetari i Komisionit me juristen, pra mua, dhe të gjithë anëtarët e komisionit shikonin këtë dokumentacion me radhë. Pasi hapeshin gjithë zarfat, gjithë komisioni i tenderit argumentonin me njëri tjetrin pozicionin që do të mbanin ndaj dokumentacionit të cdo firme. Në prani të firmave përcaktoheshin firmat e kualifikuara dhe të skualifikuara të cilave u paraqiteshin mangësitë e tyre. Për këtë veprim mbähej procesverbali përkatës në të cilin shënoheshin mangësitë që kishte dokumentacioni i firmave të skualifikuara. Firmave të skualifikuara i kthehej mbrapsht të pahapura ofertat ekonomike dhe vazhdonte procedura me leximin e ofertave hapshin nga unë dhe lexohej me zë të lartë cmimi i ofruar, në formularin e ofertës. Oferta me gjithë preventivin i kalohej KVO të cilët firmosnin në cdo fletë. Për paqartësi në preventiv pyeteshin pergjegjës në sallë dhe ata firmosnin në rastet kur oferta e tyre kishte paqartësi në preventiv. Në këto raste në vendet ku kishte paqartësi u kërkohej përfaqësuesve të firmave të firmosnin në këto vende. Më pas ofertat merreshin nga njësia e prokurimit të cilët i

*Am*

12  
fotokopjonin ato. Dokumentat origjinale të tenderit mbaheshin nga kjo njësi e cila mbante edhe korrigjimin e gabimeve aritmetike mbi fotokopjen e ofertës së paraqitur.....

**Pyetje:** A i keni parë ju ofertat dhe a keni vënë re korrigjime në preventivat e tyre?

**Përgjigje:** Në tenderat e zhvilluar, unë nuk i kam parë me imtësi preventivat e paraqitur nga ofertuesit. Mbjaj mend që në rastet kur kishte paqartësi në numrat e shkruajtur, nga anëtarët e KVO i kërkohej firmës të konfirmonte numrin e shkruajtur duke firmosur në krah. Pasi bëhej korrigjimi i gabimeve aritmetike i cili në 2002 bëhej nga inxhinieri Arta Tani ose Shpresa Noka dhe në vitit 2003, bëhej nga ekonomistja Merita Tërshana. Pasi bëhej korrigjimi përkatës i gabimeve, njësia përpilopnte procesverbalin ku pasqyrohej cmimi sa kishte qënë dhe sa kishte dalë pas korrigjimit të gabimeve, shpeshherë këtë procesverbal e bëja edhe unë....

**Pyetje:** A janë ballafaquar preventivat origjinale të firmave me preventivin me vlerat e korrigjuara, zë për zë dhe a është mbajtur procesverbal për korrigjimet e kryera?

**Përgjigje:** Në KVO janë paraqitur të gjitha vlerat e korrigjuara, ofertat origjinale, procesverbalet dhe janë ballafaquar preventivat. Nuk di të them nëse ato janë ballafaquar zë për zë nga anëtarët e KVO.

**Pyetje:** Ju paraqesim ofertat e korrigjuara në tenderat me objekt Rikonstruksion i konviktit të shkollës së mesme ekonomike Tiranë, Rikonstruksion i konviktit të shkollës së mesme të Muzikës Elbasan, Qebdra Kulturore e Fëmijëve Vlorë, Shkolla e Gjuhëve të Huaja Korçë, Rikonstruksion i konviktit të shkollës së mesme tregtare Vlorë, Godinë e re për Universitetin Fan Noli Korçë dhe Rikonstruksion i konviktit të shkollës së mesme K.Isak Berat. Në crethana jeni vënë në dijeni të këtyre korrigjimeve, a i keni parë ato në momentit e hapjes së ofertave, a janë analizuar këto ndryshime nga Njësia e Prokurimit dhe nga KVO dhe pse janë pranuar si të vlefshme këto oferta në kundërshtim me nenin 32 / 1 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me nenin 21 të Udhëzimeve për Pjesëmarrësit në tender sipas të cilit "cmimi për njësi duhet të jetë i qartë, pa korrigjim?"

**Përgjigje:** Cmimet e korrigjuara janë parë pasi janë bërë korrigjimet e gabimeve aritmetike në ofertë dhe anëtarëve të KVO i janë vënë në dispozicion të gjitha materialet. Nuk mbaj mend që nga KVO të jenë analizuar ndryshimet e cmimeve zë për zë. Nga ana ime, si anëtare e njësisë së prokurimit, jam e sigurtë që ky veprim nuk është bërë pasi nuk është detyrë ime. Ofertat janë pranuar si të vlefshme pasi cmimet për njësi kanë qënë të qarta dhe unë nuk i kam hyrë vlerësimit të ofertës.....

**Pyetje:** Pse nuk keni bërë pezullimin e procedurave të tenderit, bazuar në Udhëzimin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi keni vënë re oferta të pranuar si të vlefshme në kundërshtim

redh

137  
me këtë ligj dhe me nenin 21 të Udhëzimeve për Pjesëmarrësit në tender sipas të cilit "cmimi për njësi duhet të jetë i qartë, pa korrigjim?"

**Përgjigje:** Vlerësimin e ofertës e bënte Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e në këto kushte kam gjykuar që skisha pse ti hyja unë në përmbajtje cdo oferte.

**Pyetje:** A kanë marrë dijeni ofertuesit për korrigjimin e bërë në ofertat e tyre, si e kanë marrë këtë njoftim, a i kanë pranuar korrigjimet e bëra nga ju, në cformë e kanë bërë këtë pranim dhe pse nuk është bërë procesverbali përkatës për këtë veprim?

**Përgjigje:** Ofertuesit e kualifikuar janë njoftuar zyrtarisht me shkresë, për vlerën e ofruar dhe vlerën e korrigjuar. Ata janë njoftuar edhe me telefon e shkresa ka qënë e protokolluar me firmë të Kryetarit të KVO. Janë pritur afatet për ankimim dhe në rastet kur nuk ka patur asnjë ankim nga ofertuesit e klasifikyuar ka vazhduar procedura me propozimin e fituesit. Fakti që nuk është bërë ankim ka nënkuptuar pranimin e korrigjimit të gabimeve nga ai. Procesverbal për cdo korrigjim në preventiv nuk është mbajtur, pasi është gjukuar që procesverbali që përcaktonte ndryshimin e vlerës nga ajo e ofruar në atë të korrigjuar në total ishte i plotë dhe i mjaftueshëm.....

Gjë tjetër nuk kam për të shtuar.....

Procesverbali pasi lexohet firmoset pa vërejtje.....

**DEKLARUESI**

*Valbona Sahajolli*

*Sahajolli*

**Of.Pol.Gjyqwsore  
Enklid GJINI**

*Poluroni*

*Beshiri Cani*

*Can*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

**VENDIM**

"Për regjistrimin e procedimit penal"

Në Tiranë, viti 2004, muaji Maj, data 07

Unë **Vexhi MUÇMATA**, me detyrë Prokuror i Rrethit Gjyqesor  
Tirane, pasi studiova materialin kallëzues nr 1768 te vitit 2004,

**KONSTATOVA**

Me date 07.05.2004 ne Prokurorine e rrethit Gjyqesor  
Tirane, nga Kontrolli i Larte i Shtetit Tirane, ka ardhur kallezimi  
penal nr 1768, ne te cilin kallezohen per ndjekje penale shtetasit  
Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Kujtim Bilaj, Valbona  
Sanxhaktari, Shpresa Noka, Arta Tani, dhe Osman Dollani se ne  
prokurimin e fondeve publike te MASH, per vitin 2003, ne  
bashkepunim ka kryer vepren penale te vjedhjes duke  
shperdoruar detyren.

Për këto arsye, bazuar ne nenin 287 te K.Pr. Penale,

**VENDOSA**

Të regjistroj procedimin penal, për veprën penale te  
"vjedhjes duke shperdoruar detyren" kryer ne bashkepunim,  
parashikuar nga neni 135-25 te K.P ne ngarkim te Agim Minxhozi,  
Sokol Turani, Dafina Cenaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari,  
Shpresa Noka, Arta Tani, dhe Osman Dollani  
Për hetimin e këtij procedimi ngarkohet prokurori **Besnik**

**CANI**

**PROKURORI I RRETHIT**

**Vexhi MUÇMATA**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086 / Prot.  
118

Tirane, me 5.05 2004

PROKURIMI NR. 1325  
DATE 07.05.2004

Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare

TIRANE

**LE N D A : KALLEZIM PENAL:**



*Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Arben Avduli, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".*

*Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomiko-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtrojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Rikonstrukcion i konviktit te shkolles se mesme tregtare, Vlore", me fond limit 43.000.000 leke,** me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.6 date 06.03.2003. Sipas ketij urdheri eshte ngritur Komisioni i






REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

1326  
07-05-2004

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086 / Prot.  
16

Tirane, me 5-05 2004



Prokurorise prane Gjykares se Shkalles se Pare

TIRANE

**LEND A : KALLEZIM PENAL:**

*Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Sokol Bilbilushi, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Shpresa Noka, Arta Tani dhe Osman Dollani, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".*

*Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomiko-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtrojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Rikonstruksion i konviktit te shkolles se mesme K Isak, Berat", me fond limit 17.000.000 leke,** me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.16 date 22.08.2002. Sipas ketij urdheri eshte ngritur Komisioni i



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086 / Prot.

Tirane, me 5.05 2004

20

PROC. PENAL Nr. 1322  
DATA 05.05 VITI 2004

KALLZIM Nr. 1364  
DATA 05.05 VITI 2004

Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare

TIRANE

**LEND A : KALLEZIM PENAL:**

*Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Tatiana Bregu, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".*

*Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomik-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtrojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Shkolla e re e gjuheve te huaja, Korce"**, me fond limit **55.000.000 leke**, me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.6 date





REPubLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania ,Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Tirane, me 5.05 2004

Nr 1086 / Prot.

19



Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare

TIRANE

**LE N D A : KALLEZIM PENAL:**

Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Arben Avduli, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".  
Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.

Kontrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomiko-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences:

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt "Godine e re per Universitetin F.Noli, Korce", me fond limit 50.000.000 leke, me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.6 date

### PROCES VERBAL

I mbajtur sot më datën 27.09. 2002, për klasifikimin e firmave që u janë hapur ofertat ekonomike për tenderin e objektit Rikonstruksioni i Konviktit të shkollës së mesme Ekonomike Tiranë

Pas shqyrtimit të ofertave të paraqitura nga firmat dhe pas korigjimit për gabime aritmetike rezulton klasifikimi si më poshtë:






| Nr | Emërtimi I Firmës | Vlera e ofruar në lekë | Vlera e korigjuar në lekë |
|----|-------------------|------------------------|---------------------------|
| 1  | Murati            | 24523267               | 28252712                  |
| 2  | Derveni           | 29606845               | 30785235                  |
| 3  | Colombo           | 31164002               | 31038878                  |




99  
99  
2

Firma Avduli dhe Eurondërtim 2000 skualifikohen për mungesë të një flete preventivi në ofertë.

Firmat që kanë korigjime nga vlera e ofruar do të paraqiten për të pranuar korigjimet e bëra nga komisioni.

### KOMISIONI

Agim MINIXHOZI   
 Sokol TURANI   
 Arta TANI   
 Dafina CENAJ   
 Kujtim BILAJ 

Valbona SANXHAKTARI   
 Sokol BILBILUSHI   
 Shpresa NOKA 



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

**V E N D I M**

*"Për regjistrimin e procedimit penal"*

*Në Tiranë, viti 2004, muaji Maj, data 07*

*Unë **Vexhi MUÇMATA**, me detyrë Prokuror i Rrethit Gjyqesor  
Tirane, pasi studiova materialin kallëzues nr 1771 te vitit 2004,*

**K O N S T A T O V A**

*Me date 07.05.2004 ne Prokurorine e rrethit Gjyqesor  
Tirane, nga Kontrolli i Larte i Shtetit Tirane, ka ardhur kallezimi  
penal nr 1771, ne te cilin kallezohen per ndjekje penale shtetasit  
Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Kujtim Bilaj, Qerim  
Ribaj, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi, Valbona sanxhaktari dhe  
Moisi Islami se ne prokurimin e fondeve publike te MASH, per vitin  
2003, ne bashkepunim ka kryer vepren penale te vjedhjes duke  
shperdoruar detyren.*

*Për këto arsye, bazuar ne nenin 287 te K.Pr. Penale,*

**V E N D O S A**

*Të regjistroj procedimin penal, për veprën penale te  
"ujedhjes duke shperdoruar detyren" kryer ne bashkepunim,  
parashikuar nga neni 135-25 te K.P ne ngarkim te Agim Minxhozi,  
Sokol Turani, Dafina Cenaj, Kujtim Bilaj, Qerim Ribaj, Merita  
Tershana, Sokol Bilbilushi, Valbona sanxhaktari dhe Moisi Islami  
Për hetimin e këtij procedimi ngarkohet prokurori **Besnik  
CANI***

**PROKURORI I RRETHIT**

**Vexhi MUÇMATA**




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT  
Departamenti i Kontrollit të Administratës  
Lartë Shtetërore dhe Prokurimeve Publike

PROC PENAL Nr. 1329  
09.05.2004

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tirane -Albania, Tel.04 251 267, Fax. 04 232 491

Nr. 1086 / Prot.  
125

Tirane, me 09.05.2004



Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare

TIRANE

**LEND A : KALLEZIM PENAL:**

*Ndaj: Agim Minxhozi, Sokol Turani, Dafina Cenaj, Qerim Ribaj, Kujtim Bilaj, Valbona Sanxhaktari, Merita Tershana, Sokol Bilbilushi dhe Moisi Islami, per konsumim ne bashkepunim te elementeve te vepres penale "Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren".  
Baza ligjore: Nenet 25, 26 dhe 135 te Kodit Penal.*

Kontrolli i Larte i Shtetit gjate periudhes Tetor 2003- Janar 2004, ka ushtruar kontroll ekonomiko-financiar prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Gjate kontrollit u konstatuan shkelje te dispozitave ligjore ose mangesi ne zbatimin e tyre, te cilat jane trajtuar ne Raportin Perfundimtar te Kontrollit. Disa prej ketyre shkeljeve mbartin elemente te veprave penale qe ndiqen kryesisht dhe duke qene se per keto morem dijeni gjate ushtrimit te detyres, bazuar ne Kodin e Procedures Penale, neni 281, po jua parashtrojme si me poshte:

Ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences eshte zhvilluar tenderi me objekt **"Qendra Kulturore e Femijeve, Vlore", me fond limit 15.000.000 leke, me procedure prokurimi "tender i hapur", sipas urdherit te prokurimit nr.6 date**